



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT**

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë e Hungarisë ka shpallur thirrjen për aplikim për bursat e Universitetit Veror Balassi 2025. Ky program ka për qëllim të mbështesë pjesëmarrësit e huaj në zhvillimin e njohurive në gjuhën hungareze dhe të forcojë lidhjet e tyre me kulturën dhe historinë e Hungarisë.

Programi koordinohet nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Hungarisë duke mbështetur me bursa verore për një periudhë 4-javore kandidatët që përmbushin kriteret e pranimit, si më poshtë:

1. Formulari i aplikimit – plotësohet online në faqen zyrtare të programit;
2. CV (Curriculum Vitae) – e përditësuar, e preferuar në formatin Europass;
3. Kopje e pasaportës – duhet të jetë e vlefshme për të paktën 6 muaj pas përfundimit të kursit;
4. Letër motivimi – duke shpjeguar:
 - Arsye pse kandidati dëshiron të ndjekë kursin;
 - Si do ti përdorin njohuritë e fituara në të ardhmen;
 - Pse është i interesuar për kulturën dhe gjuhën hungareze.
5. Çertifikatë që vërteton njohuritë e hungarishtes (nëse ka);
6. Rekomandim nga një institucion arsimor ose punëdhënësi (opsionale, por e preferuar).

Ky program zgjat 4 javë (15 korrik – 9 gusht 2025), me vendndodhje në Budapest. Lëndët që përfshihen janë gjuhë dhe kulturë hungareze.

Kostot e mbuluara nga bursa përfshijnë: shpenzimet e mësimdhënies, akomodimi dhe ushqimi (mëngjes dhe drekë) si edhe ekskursione kulturore.

Aplikimet pranohen vetëm në mënyrë elektronike përmes platformës zyrtare <https://balassieducation.hu/>, afati i fundit për aplikim është data 29 prill 2025.

Aplikimet do të vlerësohen deri më 20 maj 2025 dhe aplikantët do të njoftohen për rezultatet përmes e-mail nga Ministria e Punëve të Jashtme. Aplikantët e suksesshëm duhet të konfirmojnë pranimin e bursës përmes postës elektronike deri më 26 maj 2025.

Për më shumë detaje, mund të kontaktoni Ambasadën e Hungarisë. Programi është i promovuar në Facebook në faqen zyrtare të Balassi Education: facebook.com/balassieducation.

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE
ASISTENCËS**

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al